



Permbledhje joteknike e aktiviteteve

“Menaxhimi i mbetjeve, ID 5.10 b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.”



Subjekti: “Zeqillari” sh.p.k

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2024



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit nezbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Subjekti "Zeqillari" sh.p.k me administrator **Z. Adriatik Zeqillari** eshte regjistruar prane QKB me NIPT L61912024O per ushtrimin e aktivitetit "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart". Aktiviteti zhvillohet ne Zona kadastrale 1594, me Nr. Pasurie 1/80/1, me siperfaqe totale 446.4 m², Erseke, Kolonje.

Siperfaqja totale e territorit ku do te zhvillohet aktiviteti sipas certifikates se pronesise eshte **446.4 m²**.



Koordinatat ne sistemin ALBANIAN 1986/GK4

X	Y
4473893.16	4468081.48
4473886.57	4468068.54
4473858.53	4468077.67
4473863.87	4468091.33



Procesi teknologjik

Aktiviteti I shoqerise “Zeqillari” per te cilin kerkohet kjo license eshte nje nder proceset qe zhvillohen ne kantieret e ndertimit te objekteve civile, industriale dhe social kulturore. Gjate fazes se prishjeve te objekteve ekzistuese, apo gjate fazes se germimeve per hapjen e gropes ne sheshin e ndertimit apo gjate fazes se nivelimit te sheshit te ndertimit gjenerohen sasira te mbetjeve inerte dhe dheu apo shtufe te cilat konsiderohen si mbetje te ngurta te parrezikshme. Nder keto mbetje mund te jen dhe mbetje urbane apo llumra .Mbetjet inerte apo dhe ato urbane grumbullohen ne vend depozitimin e shoqeris Zeqillari shpk .Pasi behet perpunimi I mbetjeve inerte ato transportohen ne landfillet perkatese ku shoqeria Zeqillari shpk ka lidhur kontratat e sherbimit per mbetjet Inerte dhe Urbane .

Mbetjet e mesiperme diferencohen qe ne vendburim /vendepozitim . Keto lloj mbetjesh jane pothuajse 100 % te riciklueshme dhe mund te menaxhohen me lehte nga landfill-I zones. Aktiviteti I grumbullimit dhe transportimit te ketyre mbetjeve do te kryhet nga automjetet e shoqerise Zeqillari te marra me qira per kete qellim. Pas grumbullimit te ketyre mbetjeve ne kantierin e ndertimit behet ngarkimi I kamioneve veteshkarkues me supersponte dhe te mbuluar me ane te eskavatoreve qe shoqeria disponon. Sapo ngarkohet kamioni me mbetjet e gjeneruara, brenda kantierit behet nje larje e gomave te kamioneve ne dalje te kantierit me qellim qe baltrat e ngjeshura ne gomate e tyre te mos dalin nga perimetri I kantierit. Me daljen nga kantieri kamionet I drejtohen shesh-depozitimeve apo Landfill-eve te caktuara nga Njesia e Qeverisjes Vendore Ne raste e kushte te caktuara, ne varesi edhe te sasise mund te menaxhohen edhe nga subjekte qe kryejne riciklim apo asgjesimin e tyre sipas kushteve teknike te pershtatshme e teknologjive miqesore me mjedisin (Kjo vlen vetem per mbetjet qe gjenerohen ne kantier te kategorise Mbetjet urbane.

Ky aktivitet perفشin procesin e ruajtjes apo magazinimit te mbetjeve te gjeneruara ne kantier, pasi kryen vetem grumbullimin ne momentin e gjenerimit dhe transportimin direkt te tyre ne pikat e grumbullimit, ne venddepozitimet e caktura nga organet e qeverisjes Vendore apo Landfill-et perkates.

Shoqeria disponon mjete dhe automjete te cilet bejne te mundur ngarkim-shkarkimin e mbetjeve , mjete te cilat jane me kontrate qiraje. Sasia e mjeteve apo tipet e mjeteve mund te shtohen apo reduktohen ne baze te volumeve te punes, por ne cdo rast dhe per cdo kontrate pune . Gjithashtu ne secilin prej kantierëve ne te cilin zhvillohet aktivitet, kryhet edhe larja e mjeteve te renda te transportit, me qellim qe baltrat te mos dalin nga sheshi I ndertimit. Larja behet ne afersi te daljes nga kantieri. Gjithashtu theksojme se te gjithë kamionet (qe perdoren per transportimin e mbetjeve te gjeneruara ne kantier), jane me super sponte dhe te mbuluar, te cilat permbushin specifikimet teknike te paracaktuara.

Mbetjet qe prodhohen gjate punimeve te prishjes apo te ndertimit te objekteve apo te rrugeve te percaktuara sipas projektit, jane shenuar si me poshte me kodet perkatese bazuar ne Vendimin Nr. 99 , date 18.02.2005 " Per Miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve ".

**KODET E MBETJEVE TE CILAT MUND TE HASEN GJATE PROCESIVE TE PUNES:**

- 10 11 03 Mbetje te materjaleve me fibra qelqi
- 15 01 07 Mbetje amballazhi qelqi
- 17 01 01 Beton
- 17 01 02 Tulla
- 17 01 03 Tjegulla dhe qeramika
- 17 01 07 Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06
- 17 02 02 Qelqe
- 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03
- 20 03 01 Mbetjet e përziara urbane
- 20 03 02 Mbetje nga tregjet
- 20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve
- 20 03 04 Llumra nga gropat septike
- 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza
- 20 03 07 Mbetjet të vëllimshme
- 20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37
- 20 01 39 Plastikë
- 20 01 40 Metalet
- 20 01 41 Mbetjet nga pastrimi i oxhaqeve
- 20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuara
- 20 02 Mbetjet e kopshteve dhe parqeve (përfshirë mbetjet e varrezave)
- 20 02 02 Dhera dhe gurë
- 20 03 02 Mbetje nga tregjet
- 20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve



2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozicioni Gjeografik

Kolonja shtrihet në pjesen Juglindore të Shqipërisë, bën pjesë si njësi fiziko-gjeografike në krahinën malore qendrore, pjesa jugore. Erseka është kryeqendra e rrethit të Kolonjës.



Gropa e Kolonjës shtrihet në këto koordinata gjeografike: lindje 20 47' 3"; perëndim 20 27' 30"; veri 40 29' 30"; jug 40 5' 0" dhe ka lartësi rreth 1100 m mbi nivelin e detit. Në lindje të saj ndodhet mali i Gramozit me një lartësi prej 2523 m mbi nivelin e detit. Në perëndim të saj ndodhet Mali i Radomit. Pragu i Qarrit e ndan këtë Gropë nga Fushgropa e Korçës, dhe në jug të saj shtrihet Malësia e Leshnjes-Barmashit dhe malit Radom.

Kjo Gropë përshkohet nga një sërë përenjsh të cilat përmbledhen në pellgun ujëmbledhes të Osumit, kemi përroit e Kozelit, Skorovotit, Starjes, Taçit e Prodanit dhe një sërë rrymash uji më të vogla me karakter stinor të aktivitetit të tyre. Gropa e Kolonjës është njësi fiziko - gjeografike më e rëndësishme për këtë zonë. Këtu jeton pjesa më e madhe e popullsisë së këtij rrethi.

Lumi i Osumit i kalon tërthor Gropës në pjesën perëndimore të saj. Në këtë Gropë është vendosur dhe vendbanimi parahistorik i Ollmit të Qinamit i cili ndodhet në majë e një kodre në afërsi të fshatit Qinam si dhe shume vendbanime te hereshme ne forme kalash te shkateruara. Mali Gramoz Shërben si kufi ndarës i kësaj zone nga territori i Greqisë.

Rrëzë këtij mali janë vendosur një sërë fshatrash si Butka, Bezhanj, Mileci, Skorovoti, Kreshova, Starja, Rehova, Taçi, Prodanit dhe Gjonçi. Në qendër të Pllajës së Kolonjës janë fshatrat Helmës, Qafëzez, Mollas, Shtikë, Qinam, Selenicë, Vodicë, Bejkovë, Psar, qyteti i Ersekës, Lëngëz, Gostivisht, Kodras, Kabash dhe Borovë. Në anën perëndimore te saj ndodhen fshatrat Kagjinas, Novosele, Mesicke, Zharkanj, Luaras, Psar i zi, Blush, Boshanj dhe Qafzez. Rruga nacionale Korce-Erseke Leskovik-Tre Urat-Permet e pershkon Pllajen e Kolonjes nga veriu ne jug ne nje gjatesi prej 85 km prej Qafes se Qarit (kufi me gropen e Korces) e deri ne Tre Urat ose Çarçovë, qe eshte dhe kufiri me rrethin e Permetit. Por Kolonja ka ne perberjen e saj si rreth edhe krahina te tjera te rendesishme dhe historike si



Zona te Dangellise me fshatrat Kurtes, Orgocke, Qinam, Radoviske; Zona e Shenmertirit me fshatrat Kaltanj, Qesarakë, Selenicë e pishës, Qytezë, Shënmërtir, Luaras, Blush, Boshanj; Zona e Piskalit me fshatrat Shijan, Goroshijan, Piskal, Vitisht, Gaduc, Polenë, Mbreshtan, Dermar, Rajan; Zona e Barmashit me fshatrat Barmash, Leshnjë, Shalës, Gërmenj, Podë, Sanjollas, Kamnik, Radimisht e Bënjëz; zona e Shqerisë me fshatrat Kovaçisht, Peshtan, Gjyrokarrë, Lashovë dhe Postenan si dhe zona e Leskovikut me fshatrat Radanj, Vrepcke, qyteti i Leskovikut, Cerckë, Radovë, Pobickë, Radat dhe Glinë

Klima

Klima e gropës së Kolonjës është e freskët dhe kushtëzohet nga pozita gjeografike dhe sidomos nga lartësia e madhe mbi nivelin e detit (mbi 1000 m), ekspozimi i saj nga veriu (lartësia relative e pragut të Qarrit 200-300 m) e nga jugu (lartësia relative e pllajës së

Shalësit 200 m) si dhe nga grykat e qafat e shumta në lindje dhe në në të cilat fryjnë erëra, që ndikojnë në klimën e kësaj grope.

Temperatura mesatare vjetore është 9.8°C, e janarit 0.6°C, e gushtit 18.6°C dhe amplituda e temperaturës vjetore 18°C. Kjo amplitudë është më e vogël se ajo e Korçës për arsye të hapjes më të madhe të saj dhe të ventilimit më të madh. Kjo dukuri ndikon edhe në vlerat jo shumë të theksuara të maksimumeve dhe minimumeve absolute. Kështu, maksimumi absolut në këtë gropë është 34.9°C, ndërsa minimumi absolut—19.5°C. Periudha vegjetative në të arrin në rreth 180 ditë. Ngricat janë një dukuri e zakonshme dhe zenë rreth 30 ditë në vit.

Reshjet në këtë gropë janë të pakta, me një mesatare vjetore deri në 943 mm. Stina më e lagët është dimri me 319.3 mm dhe pas tij vjen vjeshta me një ndryshim të vogël. Stina më e thatë është vera me 3 herë më pak reshje se dimri. Kjo dukuri sic thamë, është pasojë e ndikimit kontinental. Reshjet e dëborës zenë një vend të rëndësishëm, ato formojnë shtresë mesatarisht deri në 30-40 ditë në vit.

Klima ka ndikim të drejtpërdrejtë sepse zonat e thella malore kanë klimë më të ashpër se pjesa e brendshme, për pasojë ka çuar në krijimin e një sërë vendbanimesh rurale pranë rrugës nacionale Korçë – Leskovik. Gjithashtu një tjetër aspekt është edhe turizmi i cili është një degë jo shumë e zhvilluar pavarësisht potencialit të madh turistik që ofron kjo zonë. Këtu mund të zhvillohet si turizmi i bardhë dhe ai historik. Si zona më të vizituara mund të përmendim zonën e Gërmenjit dhe atë të Shelegurit. Por, klima këtu luan rolin e saj, sepse duke qenë një klimë me dimër të ashpër, me temperatura shumë të ulëta nuk lejon zhvillimin e turizmit.

Hidrografia

Hidrografia ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse çdo vendbanim rural dhe urban është i vendosur pranë një rrjedhje ujore. Duke qënë të vendosur pranë këtyre pjesëve popullsia e zhvillon aktivitetin e saj ekonomik. Gjithashtu kohët e fundit rrjeti hidrografik po përdoret edhe për prodhimin e energjisë elektrike ku mund të përmendim Hec-in e ndërtuar në lumin Osum.



Gropa e Kolonjës dallohet për një rrjet shumë të dendur hidrografik. Por rrjedhjet janë të vogla, shumica e tyre të përkohshme madje ka edhe nga ato që kanë ujë vetëm për një periudhë shumë të shkurtër, pas shirave të gjatë ose pas shkrirjes së menjëhershme të dëborës. Kjo dukuri është e lidhur sidomos me filtrimin e madhe të ujit në strukturën e kryqëzuar të piemontit të Kolonjës.

Të gjitha rrjedhjet e kësaj grope dallohen për luhatje të mëdha të niveleve, pra fryrje dhe rënie të menjëhershme të nivelit të tyre. Kjo dukuri është e lidhur sidomos me formën e zgjeruar në pjesën e poshtme të pellgjeve ujëmbledhëse, me pjerrësinë shumë të madhe të shpateve të këtyre pellgjeve dhe të shtretërve të rrjedhjeve ujore. Rol të rëndësishëm luan gjithashtu përbërja prej flishi dhe varfëria bimore. Rrjedhjet ujore të gropës së Kolonjës dallohen edhe për prurje shumë të madhe të ngurtë. Jo rrallë ato marrin trajtën e rrjedhjeve të baltës.

Tokat

Tokat përhëhen kryesisht nga tokat e kafenjta, të cilat në sektorët e sheshtë ose me pjerrësi të vogël kanë profil të plotë deri në 1 m), ndërsa në sektorët e pjerrët janë mjaft të cekëta. Në pjesën lindore dhe gjatë shtretërve të përrenjve gjenden tokat primitive.

Bimësia

Bimësia e gropës së Kolonjës ndonëse e pakët, ka tipare të shprehura kserofile dhe përbëhet kryesisht nga shoqërimet e dushkut. Vitet e fundit ajo është zëvendësuar nga bimët e kultivuara. Gjatë viteve të pushtetit popullor mjedisi gjecgrafik është transformuar gjerësisht, janë hapur toka të reja Për të cilat është siguruar ujitja, janë bërë pyllëzime dhe sistemime antierozive. Bimësia e lartë drusore në malin e Gramozit është shumë e varfër, e kushtëzuar kryesisht nga faktorët natyrorë, sidomos nga përhapja e madhe e proceseve të degradimit të relievit. Por në shpatet dhe në kreshta ka kullota të mira verore. Vetëm në pjesën jugore të tij ahishtet formojnë një pyll masiv. Kohët e fundit në shpatet e Gramozit janë bërë pyllëzime artificiale.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni të kryer.

Shkarkime në ujë

Nga ky aktivitet nuk do të ketë përdorim të ujit në procesin teknologjik por vetëm për përdorim sanitar pasi sipërfaqja në pronësi të subjektit “Zeqillari” sh.p.k. do të përdoret vetëm për ruajtjen e perkoheshme të mbetjeve. Shkarkimet sanitare nuk konsiderohen



shkarkime pasi nuk gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit. Perdorim te ujit mund te kete ne sezonin e thate per uljen e perqendrimit te pluhurit.

Emetimet ne ajer

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti do te kemi emetime te lehta ne ajer ne mjediset e jashtme. Ky emetim do te vije si pasoj e clirimit te gazeve dhe te grimcave te pluhurit nga levizja e automejteve te transportit te mbetjeve inerte ku sasia me e larte e clirimit te grimcave te pluhurave do te jete ne momentet kur do lendet do te depozitohen ne subjekt.

Ndikimet ne toke

Ndikimet ne toke do te jene minimale, kjo per vete faktin se punimet qe do te realizohen per transferimin e mbetjeve te ngurta do te zhvillohen ne sheshin e shtruar me cakell, duke e perjashtuar mundesin e kontaminimit te tokes.

Zhurmat dhe vibrimet

Ne mjediset e jashtme zhurmat dhe vibrimet do te jene prezent vetem gjate levizjes se automejteve te transportit te mbetjeve inerte per ne subjekt. Vleresimet per zhvillimin e aktiviteteve te tilla, rezultojne se nuk do te kemi gjenerim te zhurmes ne nivele te larta dhe qe mund te ndikoje ne mjedisin e zones perreth dhe punonjesit.

Mbetjet e prodhuara

Proceset qe do te zhvillohen nga veprimtaria per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme, nuk parashikojne te gjenerojne mbetje, pasi ky aktiviteti konsiston pikerisht ne menaxhimin e integruar te mbetjeve, me qellim ruajtjen perkohesisht te tyre dhe asgjesimin perfundimtar nga operator te licencuar. Theksojme se nuk do te kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen nga konsumi i perditshem ne kete objekt nga punonjesit qe bejne te mundur transportin nepermjet makinerive te mbetjeve inerte, do te jene mbetjet e ngurta si plastike, shishe qelqi, materiale letre etj. Keto mbetje duhet te menaxhohen ne bashkepunim me NJ.Q.V.



4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

- Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga NJ.Q.V, madje janë vendosur koshat që keto mbetje të ndaje sipas karakterit të tyre.
- Automjetet e transportit qarkullojnë me shpejtesi të ulët të mënyrës që të mos krijohen vibrime.
- Në pjesën e mbetur të sipërfaqes së lirë operatori ka mbjellë pemë për të krijuar një pamje vizuale të bukur por edhe për të ulur ndikimin në mjedis.
- Operatori është i kujdesshëm në mirëmbajtjen e rrugës hyrëse të subjektit
- Zbatimi rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj në rast avarie të mundshme.
- Pastrimi periodik i vend depozitimit të lëndës së parë.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit.
- Riparimi i menjhershëm i defekteve dhe avarive teknologjike.
- Pastrimi i menjhershëm në rast derdhesh të lubrifikanteve dhe grumbullimi i tyre në kontener(fuci) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimit të tyre përfundimtar.
- Monitorimi periodik i parametrave mjedisorë dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e Shoqërisë.
- Sigurimi i të gjitha mjeteve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrjen në rast emergjence.
- Trajnimi periodik i personelit dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë.



Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet ne pune

Detyrimet e punëdhënësit

Per te shmangur aksidentet ne pune, punëdhënësi vetë i ka bërë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajtur shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Detyrimet e punëmarrësit:

- Të njoh mirë proçesin e punës dhe makinerite apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojtë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstaton rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfare masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme per ndihmën e shpejtë.
- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.